



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 19 tetor 2020
Nr.ref.:RK 1628/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI196/19

Parashtrues

Jetullah Deliu

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 216/2019, i 11 korrikut 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Jetullah Deliu (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Ali Latifi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme [Rev. nr. 216/2019] të 11 korrikut 2019 në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 5367/18] të 25 shkurtit 2019 dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë [C. nr. 1419/08] të 13 shtatorit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të kontestuar, përmes të cilave pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 31 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 7 nëntor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.
7. Më 21 janar 2020, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrim të kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
8. Më 30 shtator 2020, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 27 shkurt 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë [Aktgjykimi C. nr. 3138/07], aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të bazuar, vërtetoi se parashtruesi i kërkesës ka fituar të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm në patundshmërinë e evidentuar si ngastër kadastrale nr. 3588-4, në sipërfaqe prej 252 m² në certifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme UL-719140S9-009820, ZK Prishtinë, për të cilën gjë detyrohet e paditura NA që t'ia pranojë dhe ta lejojë

paditësin që këtë të drejtë ta regjistrojë në evidencën kadastrale në Drejtorinë e Kadastrës në Prishtinë, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit.

10. Ndërkohë, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi civile kundër palës së paditur Shkolla e Mesme "Medreseja Alaudin" në Prishtinë, për shkak të pengimit të pretenduar të servitutit të kalimit. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu, bazuar në nenet 67 dhe 68 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK) kishte kërkuar përjashtimin e gjyqtarit H. S. për shkak të bindjeve të tij se gjyqtari në fjalë është i njëanshëm dhe se ndihmon palën e paditur Shkolla e Mesme "Medreseja Alaudin" në Prishtinë.
11. Më 4 shkurt 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin [GJA. nr. 172/2016], refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës të pabazuar për përjashtimin e gjyqtarit H. S. nga shqyrtimi dhe vendosja në çështjen juridike kontestimore C. nr. 1419/2008. Gjykata Themelore theksoi se bazuar në nenin 68.4 të LPK-së, parashtruesi i kërkesës është i detyruar që në kërkesën për përjashtim t'i cekë rrethanat, nga të cilat përfundon se ekziston ndonjë bazë ligjore për përjashtimin e gjyqtarit, të paraparë me nenin 67 të LPK-së. Gjykata Themelore konstatoi se nga shkresat e lëndës nuk rezulton ndonjë veprim i ndërmarrë nga gjyqtari i çështjes që mund të ngre dyshime mbi paanshmërinë dhe objektivitetin e gjyqtarit me rastin e vendosjes së çështjes.
12. Më 23 mars 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin [C. nr. 1419/08] refuzoi: (i) kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës me të cilën kishte kërkuar të vërtetohet se pala e paditur Shkolla e Mesme "Medreseja Alaudin" në Prishtinë, më 26 qershor 2008 e ka penguar parashtruesin e kërkesës në posedimin e fundit faktik të së drejtës së kalimit (servitutit të rrugës) në ngastrën P-71914059-3588-4 dhe shtëpinë e ndërtuar të parashtruesit të kërkesës në atë ngastër të cilat pasuri evidentohen sipas certifikatës së pronës P-71914059-3588-4, 5 nëntor 2015, plani dhe skica 12/11, në sipërfaqe 252 m², Zona kadastrale Prishtinë dhe (ii) refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës me të cilën kishte kërkuar të detyrohet i padituri që menjëherë ta heqë rrethojën në gjerësi 5 m, të materialit të fortë të vendosur - ndërtuar në rrugën "Bajram Bahtiri" në pjesën e ngastrës nr. 34884-1 në mënyrë që paditësi me anëtarët e familjes të vazhdoj ta shfrytëzojë të drejtën e kalimit të mëparshëm me njerëz dhe automjete nga veriu nëpër ngastër nr. 3588-1, në gjatësi prej 17.09m dhe gjerësi 5 m.
13. Në aktvendimin e lartpërmendur, Gjykata Themelore kishte shpjeguar: (i) se pala e paditur ishte pajisur me leje ndërtimi të rrethojës nga Komuna e Prishtinës; (ii) veprimet e palës së paditur nuk mund të cilësohen të kundërligjshme sepse në procedurë administrative është dhënë aktvendim nga Komuna e Prishtinës; dhe (iii) parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar asnjë provë se ka ushtruar ankesë lidhur me vendimin që i ka lejuar palës së paditur ndërtimin e rrethojës.
14. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës po ashtu kishte kërkuar

që kërkesëpadia e tij të miratohet e bazuar, të ndryshohet vendimi i shkallës së parë ose çështja të kthehet për rigjykim në shkallë të parë.

15. Më 18 korrik 2016, Gjykata e Apelit me Aktvendimin [Ac. nr. 2586/16] e refuzoi të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore [C. nr. 1419/08] të 23 marsit 2016. Gjykata e Apelit arsyetoi: (i) se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i rregullt, i bazuar në ligj dhe se nuk karakterizohet me shkelje qenësore të dispozitave kontestimore; (ii) parashtruesi i kërkesës nuk kishte sjellë prova për pushtetin e fundit faktik për pengim në posedim siç kërkohet me nenet 103 dhe 104 të Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore; dhe se, (iii) është vërtetuar që parashtruesi i kërkesës nuk e kishte pushtetin e fundit faktik sepse kishte humbur të drejtën e kalimit (servitutit) në bazë të vendimit të nxjerrë në procedurë administrative nga Komuna e Prishtinës.
16. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur propozim për përsëritje të procedurës në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar se pala e paditur Shkolla e Mesme “Medreseja Alaudin” në Prishtinë nuk ka subjektivitet juridik për të qenë palë në këtë procedurë, sepse palë e paditur duhet të jetë Bashkësia Islame e Kosovës-Prishtinë, ndërsa i padituri i dytë duhet të jetë Komuna e Prishtinës e cila ka nxjerrë vendim për lejimin e vendosjes së rrethojës, çka i kishte ndaluar parashtruesit të kërkesës të drejtën e kalimit. Bazuar në pretendimet në fjalë, parashtruesi i kërkesës kishte propozuar përsëritjen e kërkesës dhe të anulohen të pabazuara në ligj Aktvendimi i Gjykatës Themelore, C. nr. 1419/08, i 23 marsit 2016 dhe Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 2586/16, i 18 korrikut 2016.
17. Më 5 janar 2017, Gjykata e Apelit me Aktvendimin [CN. nr. 120/2016] refuzoi të pabazuar propozimin e parashtruesit të kërkesës për përsëritjen e procedurës kontestimore sipas lëndës C. nr. 1419/08. Gjykata e Apelit theksoi se prova e propozuar nga parashtruesi i kërkesës për përsëritje të kërkesës nuk paraqet ndonjë provë të re, parashtruesi i kërkesës nuk ka dhënë ndonjë arsye konkrete pse prova e paraqitur tani nuk është paraqitur më herët para se vendimi (Aktvendimi i Gjykatës Themelore, C. nr. 1419/08, i 23 marsit 2016) të bëhet i formës së prerë, Gjykata e Apelit nuk ka tagër që të lëshohet në vërtetim tjetër të gjendjes faktike e cila tashmë është vërtetuar me vendim të formës së prerë.
18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje të së drejtës materiale e procedurale, vendim të pabazuar, me “dëshmi të rrejshme” të palës së paditur dhe Komunës së Prishtinës. Parashtruesi i kërkesës kishte propozuar që ankesa të miratohet e bazuar dhe lënda të kthehet në rigjykim ose në bazë të dëshmive të ofruara të vendoset në favor të tij.
19. Më 30 prill 2018, Gjykata e Apelit me Aktvendimin [Ac. nr. 2676/17] e refuzoi të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [CN. nr. 120/2016] të 5 janarit 2017. Gjykata e Apelit vlerësoi se në rastin e parashtruesit të kërkesës: (i) nuk janë plotësuar kushtet për përsëritje të procedurës; (ii) se nga shqyrtimi i shkresave të lëndës nuk mund të konstatohet asnjë veprim i kundërligjshëm nga Gjykata e Apelit; dhe se, (iii)

pretendimi se palë e paditur duhet të jetë Bashkësia Islame e Kosovës është i pabazuar sepse Shkolla e Mesme "Medreseja Alaudin" në Prishtinë ka marrë leje për vendosjen e rrethojës dhe se vet i ka kryer të gjitha veprimet, çka do të thotë, se e njëjta ka mundur të jetë palë në procedurë.

20. Më 25 qershor 2018, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar-në Gjykatën Themelore për Gjykatën Supreme-kërkesë për revizion ndaj Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 2676/17] të 30 prillit 2018.
21. Më 13 shtator 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin [C. nr. 1419/08], e refuzoi të palejuar revizionin e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 2676/17] të 30 prillit 2018, për shkak të mosrespektimit të afatit ligjor. Gjykata Themelore theksoi se bazuar në dispozitat ligjore të nenit 211.1 të LPK-së kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë mund të paraqitet revizion në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita kur është dorëzuar aktvendimi. Gjykata Themelore konstatoi se revizioni i parashtruesit të kërkesës duhet të hedhet i paafatshëm pasi që vendimi është pranuar më 22 maj 2018, ndërsa kërkesa për revizion është dorëzuar më 25 qershor 2018, pra kanë kaluar 33 (tridhjetë e tre) ditë.
22. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar zbatim të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike me propozim që ankesa të miratohet e bazuar, ndërsa lënda të kthehet për rigjykim në shkallë të parë me nxjerrjen e një vendimi meritor.
23. Më 25 shkurt 2019, Gjykata e Apelit me Aktvendimin [Ac. nr. 5367/18] e refuzoi të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë [C. nr. 1419/08] të 13 shtatorit 2018. Gjykata e Apelit vlerësoi se nuk qëndron pretendimi i parashtruesit të kërkesës se aktvendimi i kontestuar është pranuar më 25 maj 2018 dhe jo më 22 maj 2018, për faktin se nga fletëkthesa për dorëzim personal, rezulton qartë se aktvendimin e kundërshtuar me revizion, i autorizuari i parashtruesit të kërkesës e ka pranuar në mënyrë të rregullt më 22 maj 2018. Gjykata e Apelit përfundoi se vlerësimi i shkallës së parë për paafatshmërinë e revizionit të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës është zbatuar në mënyrë të drejtë, bazuar në dispozitat e nenit 211.1 të LPK-së.
24. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që revizioni të miratohet, duke e miratuar edhe kërkesëpadinë e tij apo që aktvendimi i goditur të priset dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.
25. Më 1 korrik 2019, Gjykata Supreme me Aktvendimin [Rev. nr. 216/2019] e refuzoi të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 5367/2018, të 25 shkurtit 2019. Gjykata Supreme vlerësoi se qëndrimi juridik i gjykatave të instancës më të ulët është i drejtë dhe i ligjshëm sepse drejtë kanë zbatuar dispozitat e të drejtës procedurale dhe materiale kur kanë konstatuar se revizioni i parashtruesit të kërkesës është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor dhe, si i tillë, është hedhë

poshtë i palejuar. Gjykata Supreme konstatoi se në rastin konkret, nga fletëdorëzimi që gjendet në shkresat e lëndës vërtetohet se i autorizuari i parashtruesit të kërkesës, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 2676/2017 të 30 prillit 2018, e ka pranuar më 22 maj 2018, ndërsa revizionin kundër aktvendimit e ka dorëzuar më 25 qershor 2018 pas afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh, përkatësisht pas afatit të përcaktuar me dispozitën e nenit 211.1 të LPK-së.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të neneve 21 [Parimet e Përgjithshme], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike], 46 [Mbrotjtja e Pronës] dhe 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrotjtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
27. Parashtruesi i kërkesës pretendon *“Hapjen e hyrje-daljes në shtëpinë time të ndërtuar me leje ndërtimore, duke larguar rrethojën uzurpuese të medresesë nga rruga ime e qasjes në truall e shtëpinë time nga ish-rruga “Xhemajl Ibishi” (tani Bajram Bahtiri) siç ka thënë në ekspertizë gjyqësore gjeodeti i autorizuar gjyqësor i Gjykatës Themelore në Prishtinë. Pra, të zbatohet kërkesa e ekspertit të autorizuar të gjeodezisë”*.
28. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se Gjykata Supreme nuk ka marrë për bazë disa vendime të zyrës kadastrale dhe drejtorisë së pronës të Komunës së Prishtinës, të cilat kanë qenë të bashkëngjitura në kërkesën për revizion.

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

31. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashikojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

32. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 216/2019] të 11 korrikut 2019, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj.
33. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kushtet nga neni 48 i Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
34. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2, i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

35. Parashtruesi i kërkesës, siç është cekur më lart, në Gjykatë pretendon se janë shkelur nenet 21, 31, 41, 46 dhe 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, sepse gjykatat e rregullta në mënyrë të kundërligjshme kishin lejuar palën e paditur që të vendosë rrethojë në pronën e tij duke ia pamundësuar të drejtën e kalimit (servitutit).
36. Lidhur me këto pretendime, dhe siç është reflektuar tek pjesa që ndërlidhet me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, përtej pretendimit se vendimet e

gjykatave të rregullta janë në kundërshtim me nenet 21, 31, 41, 46 dhe 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur para Gjykatës asnjë argument ose arsyetim konkret përkitazi me shkeljet e të drejtave të tij e të cilat ai i pretendon.

37. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore sipas së cilës vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsyetim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. (Shih, në këtë kontest, rastet e Gjykatës K102/18, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafin 36; dhe K195/19, parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31).
38. Një qëndrim i tillë i Gjykatës, është i bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Bazuar në këtë praktikë, dhe atë tashmë të konsoliduar të Gjykatës, pretendimet apo ankesat e paarsyetuara dhe të pambështetura me argumente e prova, shpallen të papranueshme si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese. (Shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 4. Ankesat e paarsyetuara: mungesa e provave, paragrafët 280 deri më 283).
39. Në rastin konkret, Gjykata vëren: (i) se gjykatat e rregullta kanë shpjeguar se parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi që në procedurë administrative të ankohet ndaj vendimit të Komunës së Prishtinës, por që nuk e ka bërë; (ii) kanë shpjeguar çështjen e legjitimitetit procedural të palës së paditur; (iii) kanë shpjeguar se pala e paditur në mënyrë të ligjshme ka vendosur rrethojën të cilën parashtruesi i kërkesës pretendon se i pengon në posedim; (iv) kanë shpjeguar se në cilat raste vjen në shprehje pengimi në posedim; (v) kanë shpjeguar përse është refuzuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës për përsëritje të procedurës; dhe në fund, (vi) kanë shpjeguar përse revizioni i parashtruesit të kërkesës është i paafatshëm.
40. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme me Aktvendimin Rev. nr. 216/2019 të 11 korrikut 2019, kishte shpjeguar: *“Sipas dispozitës së nenit 211 .1 të LPK-së, parashihet se kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej 30 ditësh nga dita në të cilën u është dorëzuar aktgjykimi. Kjo dispozitë aplikohet në mënyrë adekuate edhe në procedurën sipas revizionit kundër aktvendimit në bazë të nenit 230 të LPK-së. Në rastin konkret nga fletëdorëzimi i cili gjendet në shkresat e lëndës vërtetohet se i autorizuari i paditësit aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë Ac. nr. 2676/2017 datë 30.04.2018, e ka pranuar më datë 22 maj 2018 (ditë e martë) ndërsa revizionin kundër aktvendimit e ka dorëzuar me datë 25.06.2018 (ditë e hënë) respektivisht pas afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimi të*

aktvendimit përkatësisht pas afatit të përcaktuar nga dispozita e sipërcituar, për arsye se dita e fundit për paraqitjen e revizionit ka qenë ditë (e enjte) e datës 21.06.2018 e cila ka qenë ditë pune. Prandaj, pretendimet e revizionit në këtë drejtim se ka qenë ditë jo e punës se i autorizuari i paditësit ka qenë në pushim vjetor paraqiten si të pabazuara. Aktvendimet e gjykatave të instancës më të ulët përmbajnë arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për zgjidhjen e kësaj çështje të cilat arsye i pranon edhe kjo gjykatë”.

41. Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. (Shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe, ndër të tjera, KI56/17, parashtruese e kërkesës: *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 tetorit 2017, paragrafi 42).
42. Gjykata, duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 31, 41, 46 dhe 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
43. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të shpallet e papranueshme bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 30 shtator 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues

Bajram Ljati



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

